



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 7 Ligji Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 115 Ligji Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 7 dhe 8 Rregulloren 15/2023 për Statusin, Kushtet dhe Procedurën e Emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa , si dhe Vendimit KGJK nr. 37/2024 të datës 22 shkurt 2024, shpall:

## **KONKURS**

**Pozitat e publikuara:**

- 1. Kryesues i PZAP –së – një (1) pozitë;**
- 2. Anëtar i PZAP-së – katër (4) pozita;**

**Kushtet për emërimin e Kryesuesit / Anëtarëve të PZAP-së;**

1. Gjyqtari i cili aplikon për Kryesues / Anëtar të PZAP-së duhet të plotësojë kushtet si në vijim;
  - 1.1 të jetë gjyqtar nga radhët e Gjykatës Supreme për Kryesues të PZAP-së, ndërsa për anëtar të PZAP-së të jetë gjyqtar nga radhët e Gjykatës së Apelit;
  - 2.1 të mos ketë të shqiptuar masë disiplinor, përjashtimisht masën vërejtje jo publike me shkrim;
  - 3.1 të ketë vlerësimin e performancës për tre vitet e fundit shkëlqyeshëm apo shumë mirë;

**Kandidatët të cilët nuk kanë të drejtë aplikimi;**

Të drejtë për aplikim për e Kryesuesit / Anëtarëve të PZAP-së nuk kanë kandidatët të cilët kanë shërbyer dy (2) mandate qoftë në cilësinë e Kryesuesit apo anëtarit të PZAP-së.

## **Mënyra e dorëzimit të aplikacionit;**

### **FORMULARI I APLIKIMIT**

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. ([www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org)) dhe i njëjti dorëzohet në Zyrën e pranimit të Sekretariatit të KGJK-së brenda afatit të përcaktuar.

[Shkarko Aplikacionin](#)

**Sekretariatit e KGJK-së, Rruga ‘‘Luan Haradinaj’’ nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit**

## **Afati i dorëzimit të aplikacionit;**

**Data e fillimit të aplikimi: 11 mars 2024**

**Data e fundit të aplikimit: 25 mars 2024**

## **Vërejtje:**

- dokumentacioni dhe dokumentet shtesë të dorëzuara pas afatit të paraparë me konkurs nuk do të shqyrtohen

## **RREGULLAT DHE PROCEDURAT**

Kandidatëve që aplikojnë për pozitën përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e -mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.